

VENDIM
Nr. 428, datë 26.6.2024

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE DHE TË MËNYRËS SË PËRDORIMIT TË TYRE PËR SHËRBIMET QË KRYHEN NGA SEKRETARIATI TEKNIK I KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT DHE UJIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 46/1, të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

I. SHËRBIMET DHE TARIFAT

1. Ky vendim përcakton tarifat për shërbimet, si dhe mënyrën e përdorimit të tyre për kërkesat që janë kompetencë e Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit (në vijim “KKTU”) dhe që ofron Agjencia e Zhvillimit të Territorit (në vijim “AZHT”), në cilësinë e sekretariatit teknik të KKTU-së, në zbatim të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar.

2. Tarifa ka për qëllim të mbulojë vetëm shpenzimet për procedurat administrative që AZHT-ja kryen, pavarësisht nëse shërbimi i kërkuar nuk mund të realizohet për shkaqe të ligjshme, në përputhje me ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, dhe me legjislacionin sektorial në fuqi.

3. Sekretariati teknik i KKTU-së për shërbimet që do të ofrohen në përputhje me përgjegjësitë dhe detyrat e saj, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, zbaton tarifa për shqyrtimin e kërkesave për pajisje me:

- a) leje zhvillimi;
- b) leje ndërtimi;
- c) leje për strukturë shërbimi në stacionet e plazhit;
- ç) certifikatë përdorimi;
- d) leje për shtyrje të afatit të lejes së ndërtimit;
- dh) leje për rishikim të kushteve dhe ndryshime në projekt gjatë ndërtimit;
- e) leje për ndryshim të subjektit zhvillues;
- ë) leje për ndryshim funksioni.

4. Tarifa për shqyrtimin e kërkesave për leje zhvillimi do të llogaritet në bazë të sipërfaqes së pronave që do të zhvillohen dhe niveli i tarifës është në vlerën 100 (njëqind) lekë për m². Pagesa kryhet pas konfirmimit të vendimit të miratimit të lejes së zhvillimit nga Këshilli Kombëtar të Territorit dhe Ujit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga lëshimi i faturës nga AZHT-ja. Nga ky parashikim përjashtohen aplikimet për leje zhvillimi për centralet gjeneruese të energjisë, tarifa për shqyrtimin e të cilave do të llogaritet në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë për mw. Pagesa për këto raste kryhet pas konfirmimit të vendimit të miratimit të lejes së zhvillimit nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga lëshimi i faturës nga AZHT-ja.

5. Tarifa për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi është në vlerën 1% të vlerës së investimit. Vlera e investimit llogaritet sipas preventivit të investimit, paraqitur nga kërkuesi në sistemin e-leje, sipas legjislacionit në fuqi. Pagesa kryhet pas konfirmimit të vendimit të miratimit të lejes së ndërtimit nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga lëshimi i faturës së arkëtimit nga AZHT-ja.

6. Tarifa për shqyrtimin e kërkesave për ndryshimin e subjektit zhvillues është në vlerën 1% të vlerës së investimit. Vlera e investimit llogaritet sipas preventivit të investimit, paraqitur nga kërkuesi në sistemin e-leje, sipas legjislacionit në fuqi. Pagesa kryhet pas konfirmimit të vendimit të miratimit nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga lëshimi i faturës nga AZHT-ja.

7. Tarifa për shqyrtimin e kërkesave për pajisje me leje për strukturë shërbimi në stacionet e plazhit është tarifë fikse, në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë. Pagesa kryhet pas konfirmimit të vendimit të miratimit nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga lëshimi i faturës nga AZHT-ja.

8. Tarifa për shqyrtimin e kërkesave për rishikim të kushteve gjatë ndërtimit, ndryshime në projekt gjatë ndërtimit, ndryshim funksioni, si dhe për lëshimin e certifikatave të përdorimit janë tarifa fikse, në masën 300 000 (treqind mijë) lekë. Pagesa për rishikim të kushteve gjatë ndërtimit, ndryshime në projekt gjatë ndërtimit, ndryshim funksioni kryhet pas konfirmimit të vendimit të miratimit nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga lëshimi i faturës nga AZHT-ja. Pagesa për lëshimin e certifikatave të përdorimit kryhet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga lëshimi i faturës nga AZHT-ja.

9. Tarifa për shqyrtimin e kërkesave për shtyrjen e afateve të lejes së ndërtimit është tarifë fikse, në masën 3 000 000 (tre milionë) lekë. Pagesa për shtyrjen e afateve të lejes së ndërtimit kryhet pas konfirmimit të vendimit të miratimit nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga lëshimi i faturës nga AZHT-ja.

10. Subjektet e interesuara për përfitimin e shërbimeve të përshpejtuara (*fast track*), të cilat mundësojnë marrjen e shërbimit të kërkuar, brenda gjysmës së kohës së përcaktuar mund të aplikojnë për përftimin e këtij shërbimi, kundrejt pagimit të 3-fishit të vlerës së tarifës së aplikimit, sipas tarifave të përcaktuara në këtë vendim.

11. Përfshihen nga pagesa e kësaj tarife të gjitha organet publike dhe shtetërore, në nivel qendror dhe vendor, të cilat janë në rolin e investitorit/zhvilluesit apo të objekteve publike.

12. Struktura e ngarkuar për lëshimin e autorizimit të pagesës për tarifën, të cilat depozitohen për llogari të AZHT-së është Drejtoria e Financës dhe arkëtimi kryhet sipas autorizimit, të lëshuar për këtë qëllim pranë bankave të nivelit të dytë. Mandati i pagesës ngarkohet në sistemin elektronik *e-Leje*. Modeli i faturës miratohet me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të AZHT-së.

13. Tarifa e shërbimit paguhet nga zhvilluesi, për llogari të AZHT-së, pasi t'i jetë vënë në dispozicion subjektit të interesuar apo kërkuesit fatura e arkëtitimit për këtë shërbim nëpërmjet sistemit *e-leje*. Kjo tarifë nuk përfshin tarifën që duhet të paguhet për llogari të institucioneve të tjera shtetërore gjatë procedurës së lëshimit të autorizimeve/miratimeve/lejeve dytësore, të cilat janë të domosdoshme në funksion të miratimit të lejes së zhvillimit/ndërtimit apo kërkesave, sipas pikës 3 të këtij vendimi.

II. DISPOZITA KALIMTARE

1. Agjencia e Zhvillimit të Territorit, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, merr të gjitha masat që brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi të kryhet lëshimi i faturave brenda sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit. Deri në krijimin e modaliteteve përkatëse brenda sistemit *e-Leje*, AZHT-ja mund të kryejë lëshimin e faturave dhe autorizimeve për kryerjen e pagesave, sipas tarifave të përcaktuara në këtë vendim, jashtë sistemit *e-Leje*.

2. Agjencia e Zhvillimit të Territorit merr të gjitha masat për lëshimin e faturave, sipas tarifave të përcaktuara në këtë vendim, për të gjitha vendimmarrjet e Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, që konfirmohen pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi, me përjashtim të vendimmarrjeve para vitit kalendarik 2024.

III. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Tarifat për shërbimet bëhen publike në faqen zyrtare të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit.

2. Ngarkohen Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyr në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama